FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.19 22 shkurt 2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.89, datë 28.1.2008	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të sipërfaqes 470,8 m^2, pjesë e pronës nr.180 "Batalioni i Policisë Ushtarake", Sauk, Tiranë, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomuni-kacionit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".....	665
Vendim i KM nr.90, datë 28.1.2008	Për pagat e atasheve ushtarakë, të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që shërbejnë në përfaqësinë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në shtabet e NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare.....	668
Vendim i KM nr.92, datë 3.2.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i autostradës Fushë-Krujë-Milot.....	670
Vendim i KM nr.93, datë 3.2.2008	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ndërtesës së ish-Policisë Ndërtimore, dega Tiranë te Posta Shqiptare sh.a., dhe për një shtesë në vendimin nr.363, datë 11.6.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Postës Shqiptare sh.a.".....	671
Vendim i KM nr.96, datë 3.2.2008	Për përcaktimin e aktiveve, në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, dhe të kufijve maksimalë të lejueshëm të investimeve të tyre nga shoqëritë e sigurimeve.....	673

Vendim i KM nr.97, datë 3.2.2008	Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore".....	675
Vendim i KM nr.99, datë 3.2.2008	Për revokimin e vendimit nr.329, datë 13.5.2005 të Këshillit të Ministrave "Pë procedurat e rekrutimit të ushtarëve profesionistë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë".....	679
Vendim i KM nr.100, datë 3.2.2008	Për përcaktimin e substancave të rrezikshme.....	679
Vendim i KM nr.105, datë 3.2.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Golaj të qarkut të Kukësit.....	683
Vendim i KM nr.106, datë 3.2.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Manëz të qarkut të Durrësit.....	684
Vendim i KM nr.107, datë 3.2.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Krujë të qarkut të Durrësit.....	688
Vendim i KM nr.108, datë 3.2.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Fushë-Krujë të qarkut të Durrësit.....	691
Kërkesë e MB nr.1320/1, datë 18.2.2008	Për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme të pronarit z.Besim Zenko Arapi, që preket nga zgjerimi i varrezave të qytetit, bashkia Fier.…….....	695
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Dylber Dajko.....	696

VENDIM
Nr.89, datë 28.1.2008

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË SIPËRFAQES 470,8 M^2, PJESË E PRONËS NR.180 "BATALIONI I POLICISË USHTARAKE", SAUK, TIRANË, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË RRUGËVE, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja 470,8 m^2, në pronën nr.180 "Batalioni i Policisë Ushtarake", reparti ushtarak nr.4002, Sauk, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes të kalojë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, për t'u përdorur për rehabilitimin e rrugës Sauk, Tiranë.
2. Kjo sipërfaqe, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, miratuar me vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.
3. Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit i ndalohet t'i ndryshojë destinacionin pronës së përcaktuar në këtë vendim.
4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Policia Ushtarake

Rilevim i territorit te P.U qe do te vihet ne dispozicion te rruges nacionale




dyqane
1kt
1kt
lokal
1kt
lokal
1kt
dyqan
1kt
Policia Ushtarake
VIJA E PERFUNDIMIT
TE RRUGES SE
PROJEKTUAR
15
16
17
18
19
20
21
196
197

VENDIM
Nr.90, datë 28.1.2008

PËR PAGAT E ATASHEVE USHTARAKË, TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË SHËRBEJNË NË PËRFAQËSINË USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË NATO-S, NË SHTABET E NATO-S, NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE NË SHTABET USHTARAKE NDËRKOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të nenit 20 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, të Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtarakët shqiptarë, për kohën që shërbejnë në përfaqësinë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në shtabet e NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare, trajtohen me pagë për gradë dhe shtesë për përfaqësim, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Paga e atasheut ushtarak nuk mund të jetë më e lartë se ajo e ministrit këshilltar në përfaqësitë diplomatike. Në rastet kur Ministri i Mbrojtjes, në marrëveshje me Ministrin e Punëve të Jashtme, për shkak të ngarkesës së punës, emëron edhe një ndihmës të atasheut ushtarak, ky trajtohet jo më shumë se grada diplomatike e këshilltarit të përfaqësisë diplomatike.

2. Ushtaraku përfiton edhe kompensimin për koston e jetesës, si më poshtë vijon:

- 300 euro/USD, për vendet e grupit të parë;
- 260 euro/USD, për vendet e grupit të dytë;
- 230 euro/USD, për vendet e grupit të tretë;
- 200 euro/USD, për vendet e grupit të katërt;
- 150 euro/USD, për vendet e grupit të pestë.

Kategorizimi i përfaqësive, për efekt të kostos së jetesës, është sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Paga shtrin efektet nga data e mbërritjes së ushtarakut në vendin e punës. Deri në këtë moment vazhdon të paguhet me pagën ekzistuese.

4. Ushtaraku, kur shkon për herë të parë në vendin e punës, merr, si paradhënie në valutë, pagesën e 15 ditëve, të cilën e shlyen brenda 6 muajve nga data e fillimit të detyrës. Nëse transferohet në atdhe para mbarimit të këtij afati, kundërvlerën e paradhënies së mbetur e shlyen në lekë, sipas kursit të këmbimit valutor, brenda 6 muajve pas kthimit në atdhe.

5. Paga mujore i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat personale, sipas legjislacionit në fuqi. Në bazë të saj do të paguhen edhe detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore.

6. Paga mujore i nënshtrohet rishikimit në të njëjtën formë, si të gjitha kategoritë e tjera të pagave në Republikën e Shqipërisë.

7. Pagesat për ushtarakët, që shërbejnë në vendet e Europës, bëhen në euro, ndërsa për vendet e tjera në USD.

8. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, brenda fondeve buxhetore vjetore, shpenzimet për pagat e atasheve ushtarakë të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që shërbejnë në përfaqësinë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në shtabet e NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare.

9. Pika 2 e kreut I dhe pikat 2, 3, 4, 9, 11 e 12 të kreut II të vendimit nr.115, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e shpenzimeve të atasheve ushtarakë dhe oficerëve të Forcave të Armatosura, që shërbejnë në shtabet e NATO-s", të ndryshuar, shfuqizohen.

10. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

11. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2008, ndërsa për periudhën nga 1 korriku 2007 deri më 31 dhjetor 2007 zbatohen pagat aktuale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Nr.	Emërtimi	Paga në euro	Paga në USD	Shtesë përfaqësimi
	Përfaqësia e NATO-s			
1.	Gj. Lejtnant	1100	1330	75%
2.	Gj. Major	1080	1280	60-75%
3.	Gj. Brigade	1000	1200	60-75%
	Përfaqësitë e tjera			
1.	Kolonel	900	1100	40-60%
2.	Nënkolonel	850	1040	40-60%
3.	Major	800	980	40%
4.	Kapiten	750	950	40%
5.	Toger	700	850	40%
6.	Nëntoger	650	800	40%
7.	K/Kapter	700	850	40%
8.	Kapter	620	750	40%
9.	Rreshter	500	590	40%
10.	Tetar	400	500	40%
11.	Nëntetar	350	450	40%

Shënim: Gradat gjeneral major dhe gjeneral brigade përfitojnë shtesën për përfaqësim në nivel maksimal kur emërohen në pozicionin e shefit të misionit

Lidhja nr.2

KATEGORIZIMI NË BAZË TË KOSTOS SË JETESËS

300 euro/ $	260 euro/ $	230 euro/ $	200 euro/ $	150 euro/ $
Londër Gjenevë Moskë	Vjenë Washington Paris Romë Berlin Madrid Napoli Oberamergau Brunssum Florida SHBA	Bruksel NATO Mons Athinë Ankara Hagë Stokholm Varshavë Budapest	Zagreb Izmir	Shkup Bukuresht

VENDIM
Nr.92, datë 3.2.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË

PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I AUTOSTRADËS FUSHË-KRUJË-MILOT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i autostradës Fushë-Krujë-Milot.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, në masën që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 31 091 m^2 tokë/arë, e vlerësuar me 1320 lekë/m^2, me vlerë shpronësimi 41 040 120 (dyzet e një milion e dyzet mijë e njëqind e njëzet) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 41 040 120 (dyzet e një milion e dyzet mijë e njëqind e njëzet) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda muajit janar 2008.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE TË CILËT DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS FUSHË-KRUJË-MILOT

Nr.	Emri	Sipërfaqja tokë arë	Çmimi l/m^2	Vlera në lekë
1.	Met Seferi	4 100	1320	5 412 000
2.	Ram Brahja	2 852	1320	3 764 640
3.	Taf Kasmi	1 751	1320	2 311 320
4.	Idriz Kasmi	4 791	1320	6 324 120
5.	Gjet Palaj	2 712	1320	3 579 840
6.	Pjetër Gjetani	7 498	1320	9 897 360
7.	Dervish Lama	1 938	1320	2 558 160
8.	Hamdi Lama	3 511	1320	4 634 520
9.	Hamit Lama	1 938	1320	2 558 160
	Shuma	31 091	1320	41 040 120

Vlera totale e këtij shpronësimi është 41 040 120 (dyzet e një milion e dyzet mijë e njëqind e njëzet) lekë.

VENDIM
Nr.93, datë 3.2.2008

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË NDËRTESËS SË ISH-POLICISË NDËRTIMORE, DEGA TIRANË TE POSTA SHQIPTARE SHA, DHE PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.363, DATË 11.6.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN

E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI POSTËS SHQIPTARE SHA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të ndërtesës së ish-Policisë Ndërtimore, dega Tiranë te Posta Shqiptare sh.a., sipas formularit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ndërtesa e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të shtohet në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.363, datë 11.6.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Postës Shqiptare sh.a.".

3. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Drejtori i Përgjithshëm i Postës Shqiptare sh.a. dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia / Komuna: Tiranë

Fusha e perdorimit te Prones: Godina e Policisë së Ndërtimit Tiranë

Identifikoi: [illegible] (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Sotoe Lekaj (Sekretar i F (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Stavri Ristani (Zv. Minister) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel/firma, vula)

	A			B			C			
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	8350	2/167	truall + ndërtesë	Zyrat e Nd. N. Bonesa Rr. = Jordan Misjan	truall 251 m²	ndërtesë 245 m²	Godina e Policisë së Ndërtimit Tiranë	M.P.P.T.T.	Inspektorat Ndërtimor Urbanistik	God dy Pronav

VENDIM
Nr.96, datë 3.2.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AKTIVEVE, NË MBULIM TË PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE, DHE TË KUFIJVE MAKSIMALË TË LEJUESHËM TË INVESTIMEVE TË TYRE NGA SHOQËRITË E SIGURIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 105 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kategorive të investimeve të aktiveve, në mbulim të provigjoneve teknike e matematike, dhe të kufijve maksimalë të lejueshëm të investimit të këtyre aktiveve.

2. Shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të mbajnë aktive, në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, jo më pak se vlera bruto e provigjoneve teknike.

Aktivet duhet të jenë të kategorizuara dhe të shpërndara, në mënyrë që të mos jenë të lidhura me një lloj të vetëm aktivi apo enti, si dhe të mos jenë të lidhura me detyrime të tjera, përveç atyre, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit.

3. Shoqëritë e sigurimeve të mbulojnë provigjonet e tyre teknike dhe matematike, vetëm me këto kategori aktivesh:

a) Bono thesari, obligacione, instrumente të tregut të parasë e të kapitalit, që krijohen apo vërtetojnë borxhin, e emetuar dhe të garantuar, nga organet e qeverisjes qendrore në Republikën e Shqipërisë. Me kërkesë të veçantë të shoqërisë dhe me miratim të autoritetit, shoqëritë e sigurimit mund të investojnë në instrumentet e lartpërmendura të vendeve anëtare të BE-së, të SHBA-së, Japonisë, si dhe letra borxhi, të garantuara nga organizatat ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë bën pjesë.

b) Të tjera letra me vlerë, letra borxhi, me të ardhura fikse e të ndryshueshme, të tregtuara në një treg të rregulluar.

c) Aksione në fonde investimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

ç) Aksione, si pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, të listuar në një treg të rregulluar ligjërisht, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

d) Aksione në shoqëri, sigurimi dhe risigurimi, vetëm me miratimin e autoritetit.

dh) Toka, ndërtesa dhe të drejtat mbi pasuri të patundshme në Republikë e Shqipërisë.

e) Kredi individuale hipotekore për apartamente banimi, vetëm për punonjësit e shoqërisë së sigurimit.

ë) Certifikata depozitash dhe letra të tjera me vlerë, të lëshuara nga bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë.

f) Para dhe ekuivalentë të saj (të cilat përfaqësojnë mjete monetare në arkë, mjete monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më të vogël se 3 muaj), në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, e që e kanë selinë në Republikën e Shqipërisë.

g) Shumat që detyrohen nga risiguruesit, që nuk janë pezull më shumë se një vit nga lindja e detyrimit.

gj) Pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike.

h) Depozita me shoqëri ceduese dhe borxhe të zotëruara nga ato.

i) Shuma, që detyrohen nga policmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risiguruese, nëse nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 3 muaj, por jo më shumë se 20 për qind e provigjonit të primit të pafituar.

j) Kërkesëpagesa, që rrjedhin nga pjesët e shpëtuara dhe subrogimet, të cilat nuk janë pezull më shumë se 1 vit.

k) Interesa dhe qira të maturuara, të ardhura të tjera të maturuara dhe shpenzime të parapaguara.

l) Aktive të qëndrueshme, të trupëzuara, përveç atyre të parashikuara në shkronjën "dh" të kësaj pike, të vlerësuar në bazë të normave të amortizimit.

3.1 Shoqërive të sigurimit nuk do t'u vlerësohen këto aktive, në mbulim të provigjoneve teknike:

a) Aktivet, që shërbejnë për financimin e kapitaleve të vetë shoqërisë së sigurimit apo të një subjekti tjetër, që është objekt kufizimesh rregullative nga një autoritet mbikëqyrës, brenda të njëjtit grup kapitali;

b) Letrat me vlerë të shoqërive, të cilat janë filiale, shoqëri mbështetëse, aksionarë në shoqërinë e sigurimit, apo çdo rast tjetër, që vlerësohet si palë e lidhur me shoqërinë e sigurimit.

4. Shoqëritë e sigurimit përsa u përket aktiveve dhe investimeve të aktiveve, në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, mund të investojnë jo më shumë se:

a) 40 për qind të provigjoneve, teknike dhe matematike, bruto në letra me vlerë, të listuara, si dhe letra me vlerë, të tregtuara në një treg të rregulluar dhe pjesëmarrje në fonde investimesh apo në skemat e investimeve kolektive;

b) 20 për qind të provigjoneve teknike dhe matematike, bruto në toka dhe ndërtesa, përfshirë 10 për qind në çdo pjesë toke a ndërtese, ose në një numër pjesësh toke apo ndërtesash, afër njëra-tjetrës, sa mund të vlerësohet efektivisht një investim;

c) 5 për qind të provigjoneve, teknike dhe matematike, bruto në aksione dhe letra të tjera me vlerë, të listuara në një treg të licencuar letrash me vlerë, si aksione, obligacione dhe instrumente të tjera të tregut të parasë dhe kapitalit të së njëjtës sipërmarrje apo hua, dhënë të njëjtit huamarrës. Ky kufi mund të ngrihet në 10 për qind, nëse sipërmarrja nuk investon më shumë se 40 për qind të provigjoneve teknike bruto në hua ose letra me vlerë të institucioneve emetuese a huamarrëse, ku, në secilën prej tyre, ka investuar më shumë se 5 për qind të aktiveve të veta;

ç) 10 për qind të provigjoneve teknike dhe matematike, bruto në, letra borxhi, obligacione të garantuara me aktive dhe në aksione, që nuk janë të listuara, si dhe të tjera letra me vlerë, me të ardhura fikse apo të ndryshueshme, me kusht që investimi i shoqërisë së sigurimit në një subjekt, që i emeton këto letra me vlerë, të mos tejkalojë 10 për qind të kapitalit të këtij të fundit;

d) 5 për qind të provigjoneve teknike dhe matematike, bruto në hua të pasiguruara, përfshirë 1 për qind për çdo hua të vetme;

dh) 25 për qind të provigjoneve teknike dhe matematike, në shuma që detyrohen nga cesorët, risiguruesit, si dhe pjesa e risiguruesit në provigjonet teknike, në përputhje dhe me shkronjën "g" të pikës 3 të këtij vendimi. Bëjnë përjashtim nga ky kufizim risiguruesit e klasifikuar si BBB-e më lart nga Standard & Poor;

e) 3 për qind të provigjoneve teknike bruto, në formën e parasë dhe ekuivalentëve të saj;

ë) 5 për qind të provigjoneve teknike bruto në aktive të qëndrueshme, të trupëzuara, të ndryshme nga ato të përcaktuara në shkronjën "b" të kësaj pike;

f) 15 për qind të provigjoneve teknike bruto për kreditë hipotekore, sipas përcaktimit në shkronjën "e" të pikës 3 të këtij vendimi, përfshirë 5 për qind të provigjoneve teknike neto për çdo hua të vetme;

g) 2 për qind të provigjoneve teknike bruto, në kërkesëpagesa, që rrjedhin nga pjesët e shpëtuara dhe subrogimet, përfshirë 1 për qind për çdo vlerë individuale, në përputhje me shkronjën "j" të pikës 3 të këtij vendimi;

gj) 20 për qind të provigjoneve teknike bruto në depozita me shoqëri ceduese dhe borxhe të zotëruara nga ato;

h) 5 për qind të provigjoneve teknike bruto, në interesa të llogaritura, qira të pagueshme dhe shpenzime të parapaguara.

5. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit, të cilat janë licencuar përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, që, brenda datës 31.3.2008, të përshtasin aktivet, në mbulim të provigjoneve teknike e matematike, dhe kufijtë e investimit të tyre.

Për përshtatjen e aktiveve sipas shkronjës "b" të këtij vendimi, zbatohet vetëm për periudhën nga hyrja në fuqi e vendimit deri më 30.6.2006, kufiri i sipërm, në masën 30 për qind të provigjoneve teknike bruto.

6. Vendimi nr.268, datë 28.4.2005 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kufijve maksimalë të lejueshëm për aktivet dhe investimet e aktiveve, për mbulimin e provigjoneve teknike dhe matematike, nga shoqëritë e sigurimeve", shfuqizohet.

7. Ngarkohen Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe shoqëritë e sigurimeve për zbatimin e

këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.97, datë 3.2.2008

PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT TË BANESAVE, OBJEKT I LIGJIT NR.7652, DATË 23.12.1992 "PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE SHTETËRORE", DHE I LIGJIT NR.9321, DATË 25.11.2004 "PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE DHE OBJEKTEVE, TË KTHYERA NË BANESA ME FONDET E SHOQËRIVE DHE NDËRMARRJEVE SHTETËRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 38, pika 1, dhe 39/1, pika 1 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Privatizimi i banesave, të ndërtuara nga shteti para vitit 1992, që kanë qenë objekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe që, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, figurojnë në pronësi të shtetit, të kryhet në emër të personit, i cili ka pasur kontratë qiraje me shtetin para vitit 1992, dhe të personave të tjerë madhorë të familjes, që jetojnë me të.

2. Privatizimi i banesave dhe i objekteve të kthyera në banesa, që kanë qenë objekt i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore", dhe që, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, rezultojnë ende të paprivatizuara, të bëhet në emër të personit, që ka emrin në listën e trashëguar nga ish-ndërmarrjet shtetërore, dhe të personave të tjerë madhorë të familjes, që jetojnë me të, pas miratimit nga organet e qeverisjes vendore.

3. Për organizimin e punës, plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe përgatitjen e vendimit të privatizimit, bashkitë dhe komunat të ngarkojnë strukturat përgjegjëse, që mbulojnë çështjet e strehimit. Njësia përgjegjëse për privatizimin ka për detyrë:

a) të plotësojë, në bashkëpunim me personat e përcaktuar në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, formularët e privatizimit;

b) të llogarisë tarifën e privatizimit, për çdo familje;

c) të përgatisë dosjen e privatizimit;

ç) të përgatisë kontratën e privatizimit.

4. Tarifa e privatizimit të banesave, sipas pikave 1 e 2 të këtij vendimi, të jetë sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Tarifat e privatizimit korrigjohen, për efekt të nivelit të banimit dhe të vendndodhjes, sipas koeficientëve, të përcaktuar në tabelat 2 e 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Gjendja familjare dhe rrethi i përfituesve, sipas pikave 1 e 2, të këtij vendimi, të përcaktohen sipas certifikatës së gjendjes familjare, të muajt dhjetor 1992. Tarifat e privatizimit, sipas tabelës 1, të shumëzohen me indeksin e korrigjimit të çmimeve. Për efekt të llogaritjes së këtij indeksi të merret, për bazë, muaji dhjetor 1992.

5. Për efekt privatizimi, sipas këtij vendimi, banesa të kategorisë së parë vlerësohen banesat, që ndodhen në rrugë kryesore. Ndarja sipas kategorive bëhet nga strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij vendimi.

6. Kur banesa është pjesë e një bashkëpronësie, sipërfaqja e truallit, që privatizohet, së bashku me apartamentin përcaktohen sipas kuotës së pjesëmarrjes në bashkëpronësi. Në rastin kur banesa

është individuale, sipërfaqja e truallit, që privatizohet, së bashku me banesën përcaktohen në bazë të kontratës, që personi, i përcaktuar në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, ka pasur me shtetin.

7. Tarifat e privatizimit të truallit përcaktohen, si më poshtë vijon:

a) Për qytetet Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Sarandë, Korçë, Gjirokastër, Fier, Lushnjë, Elbasan, Pogradec, Lezhë, Krujë dhe Kavajë. 1080 lekë/m^2;

b) Brenda vijave kufizuese të qyteteve të tjera 720 lekë/m^2;

c) Për zonat rurale, kjo tarifë llogaritet duke iu referuar tarifës së privatizimit të truallit në zonën periferike të qytetit më të afërt me banesën, që do të privatizohet, dhe duke e shumëzuar këtë tarifë me koeficientin 0.3.

Tarifat, sipas kësaj pike, të shumëzohen me indeksin e korrigjimit të çmimeve, sipas pikës 4 të këtij vendimi.

8. Në rastin kur trualli ka pronar një subjekt privat, të njohur nga komisioni i kthimit dhe kompensimit të pronave, zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar. Fondet e mbledhura nga shitja e objektit të përdoren për sistemimin e familjeve, që janë strehuar në këto objekte nga institucionet shtetërore.

9. Në rastin kur trualli, mbi të cilin është ngritur objekti i kthyer në banesë, është pronë e shtetit, familja ka të drejtë ta privatizojë objektin, ndërsa trualli mbetet pronë e shtetit. Në rastin kur zona rizhvillohet sipas planeve të zhvillimit urbanistik, subjekti i trajtuar me strehim përfiton strehim sipas normave në fuqi dhe gjendjes familjare. E drejta e përfitimit nga rizhvillimi i takon subjektit shtetëror, pronar të truallit.

10. Tarifa e privatizimit të banesës mund të shlyhet në mënyrë të menjëhershme ose me këste, sipas kërkesës, që bën personi, sipas pikave 1 e 2 të këtij vendimi. Tarifa e privatizimit të truallit të paguhet në mënyrë të menjëhershme.

11. Veprimet e privatizimit të kryhen pas plotësimit të formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, nga personi, sipas pikave 1 e 2. Formulari shoqërohet me planimetrinë e apartamentit, e cila hartohet dhe nënshkruhet nga projektues të licencuar, sipas matjeve në vend. Kur banesa është individuale, planimetria e banesës shoqërohet edhe me planvendosjen dhe planimetrinë e truallit.

12. Formulari nënshkruhet nga personat e përcaktuar në pikat 1 e 2 dhe nga drejtuesi i strukturës përgjegjëse, të përmendur në pikën 3 të këtij vendimi, dhe mbahet në dy kopje, njëra nga personi dhe tjetra futet në dosjen e privatizimit.

13. Pas dorëzimit të formularit, përgjegjësi i njësisë së privatizimit përgatit dosjen e privatizimit, e cila përmban:

a) kërkesën e personit për privatizimin e banesës;

b) certifikatën e gjendjes familjare, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 4 të këtij vendimi;

c) vlerën e tarifës së privatizimit të truallit dhe të apartamentit a banesës individuale;

ç) planimetrinë e apartamentit ose, në rastin e banesave individuale, planvendosjen e banesës dhe planimetrinë e truallit.

14. Kryetari i bashkisë a komunës apo personi i autorizuar prej tij lidh kontratën e privatizimit, ku përcaktohen:

a) vlera e tarifës, që i takon të paguajë personi, për privatizimin e truallit dhe të apartamentit a banesës individuale;

b) mënyra e shlyerjes së vlerës;

c) mënyra e arkëtimit të vlerës;

ç) sanksionet, në rastin e mosshlyerjes në kohë të detyrimit.

Kontrata mbahet në 3 kopje, nga të cilat njërën e merr personi, tjetra mbahet në dosjen e privatizimit dhe e treta i dërgohet për regjistrim zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP). Regjistrimi në ZVRPP i këtyre banesave të bëhet me dokumentacionin, që disponohet.

15. Me regjistrimin në ZVRPP personi fiton të drejtën e pronësisë mbi apartamentin. Në rastin kur tarifa e privatizimit shlyhet me këste, regjistrimi i pronësisë në ZVRPP bëhet duke e ngarkuar pronën me barrë hipotekore, deri në shlyerjen e plotë të detyrimit.

16. Kur banesat, e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, janë përfunduar me financime të vetë qytetarëve, shteti nuk mbart detyrim për kthimin e investimit të bërë nga qytetari.

17. Ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave, që, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, t'ia dorëzojë dokumentacionin e këtyre banesave bashkisë a komunës, ku ajo ndodhet.

18. Shumat e arkëtuara nga privatizimi i truallit dhe i banesës depozitohen në Buxhetin e

Shtetit, në “Fondin e kompensimit”, të parashikuar në ligjin nr.9235, datë 27.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, për t’u përdorur për shlyerjen e pronarëve të trojeve.

19. Ngarkohen organet e qeverisjes vendore, Enti Kombëtar i Banesave dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela 1 Tarifa e privatizimit (në/000 lekë)

ku:
A- është apartament me strukturë 1+1
B- është apartament me strukturë 2+1
C- është apartament me strukturë 3+1

Kategoria	Emërtimi	Klasifikimi i apartamenteve sipas tipeve																				
		55 vite			45-55 vite			35-45 vite			30-45 vite			25-30 vite			25-20 vite			20 vite		
		A	B	C	A	B	C	A	B	C	A	B	C	A	B	C	A	B	C	A	B	C
III	Kuzhinë më vete	-	-	8	-	-	13	-	7	17	3	12	21	6	15	24	9	18	27	12	21	30
	Pa guzhinë	-	-	5	-	-	10	-	5	14	2.5	10	18	4	12	20	6	14	22	8	16	24
II	Kuzhinë më vete	-	-	9	-	-	14	-	9	19	4	13.5	23	9	18.5	28	13	22.5	32	17	26.5	35
	Pa guzhinë	-	-	5.5	-	-	11	-	6	15	3	11.5	21	7	15.5	24	10	18.5	27	13	21.5	30
I	Kuzhinë më vete	3	6	10	3.5	8	15	4	10	20	5	15	25	10	20	30	15	25	35	20	30	40
	Pa guzhinë	2	4	6	3	6	12	3.5	8	17	4	13	22	8	17	26	12	21	30	16	25	34

Tabela 2 Koeficientët e korrigjimit të tarifës në bazë të nivelit të banimit

	Apartamete		
	1+1	2+1	3+1
Nr. frymëve	3	4	6
Koeficienti zbritës për çdo frymë tepër në %	-10	-10	-10
Koeficienti rritës për çdo frymë më pak në %	+10	+10	+10

Tabela 3 Koeficientët e korrigjimit të tarifës sipas vendndodhjes së apartametit në godinë

Vendosja e AP	**Për apartament të kategorisë së II-të**	**Për apartamete të kategorisë së I-rë**
	Koeficienti %	
Kati përdhe	-7	+10
Kati i ndërmjetëm	+5	+5
Kati i sipërm	-7	-7

LIBRI I PRIVATIZIMIT

Nr.	Emri, mbiemri	Adresa rruga, pall. shk.ap	Përbërja e apartamentit				Tarifa (në lekë)	Likuidimi		Hipotekimi	Vërejtje
			garsoniere	1+1	2+1	3+1		Me një këst	Me disa këste		

VENDIM
Nr.99, datë 3.2.2008

PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR.329, DATË 13.5.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PROCEDURAT E REKRUTIMIT TË USHTARËVE PROFESIONISTË NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 121 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Revokimin e vendimit nr.329, datë 13.5.2005 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e rekrutimit të ushtarëve profesionistë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.100, datë 3.2.2008

PËR PËRCAKTIMIN E SUBSTANCAVE TË RREZIKSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 19 të nenit 2 të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006 "Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e substancave të rrezikshme, të cilat, në përqendrime specifike, në një mjedis të caktuar, për vetitë e tyre fiziko-kimike, toksikologjike dhe ekotoksikologjike, përbëjnë burim rreziku për shëndetin, jetën e punëmarrësve dhe për mjedisin e komponentët e tij, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Personat fizikë ose juridikë, prodhues, përdorues. importues dhe/ose transportues të substancave të rrezikshme janë të detyruar të respektojnë format, standardet dhe procedurat përkatëse, sipas 1egjislacionit në fuqi.
3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe inspektoratet, në varësi të tyre, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi nr.459, datë 22.7.1998 i Këshillit të Ministrave "Për substancat e rrezikshme", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E SUBSTANCAVE TE RREZIKSHME

1. Ksilidin
2. Tetrabrom acetileni
3. Akroleina
4. Akrilamina
5. Tributil fosfat
6. Alkoli alilik
7. Alil kloruri
8. Eteri alil glicerik
9. Alil propil disulfur
10. 2, Aminoetanol
11. 2, Aminopiridina
12. Anilina dhe komponimet e saj
13. Diboran
14. Benzidina
15. Benzol
16. p-Benzokinoni
17. Benzol peroksidi
18. Benzil kloruri
19. Trifloruri i borit
20. Bromi
21. Bromoform
22. Butilamina
23. 3, Butil kromate
24. Butil merkaptene
25. p-3 butil toluen
26. Acidi perklorik
27. Klorin trifloruri
28. Aldehidi kloracetik
29. Kloracetofenone
30. 0-Klorbenziliden malonitrike
31. Klor difenili
32. Klor etanol
33. Klor etilen
34. Klorpikrina
35. Cianuret dhe acidi cianhidrik
36. 2,4,6,-Trinitrofenil
37. Trinitrotolueni
38. Triortokrezol fosfat
39. Diazometan
40. 1,2 Dibrometan
41. Dibutil fasfate
42. Dibutil ftalate
43. Triklornaftalen
44. Triklor etan
45. Dietilamina
46. 2-Dietilaminoetan
47. Eteri diglicidil
48. Diizopropilamin
49. Dimetil acet amidi
50. Dimetil amina
51. Dimetil anilina
52. Dimetil 1,2 dibron 2,2 dikloretil fosfat
53. Dimetil formamidi
54. 1,1 Dimetil hidrazina
55. Dimetilftalate
56. Dimetil sulfate
57. Dinitrobenzen
58. Dinitro-o-krezol
59. Dinitrotolucni
60. Epiklorhidrina
61. Etanol amina
62. Etil amina
63. Etil merkaptene
64. Etilen klorhidrin
65. Etilen diamina
66. Etilen glikol dinitrat
67. Fluori dhe floruret
68. Acidi formik
69. Furfurol
70. Hezakloretan
71. Hekzaklornaftaleni
72. Hidrazina
73. Acidi Bromhidrik
74. Acidi kromik dhe kromatet
75. Acidi flothidrik
76. Izopropilamina
77. Plumbi dhe komponimet e tij
78. Trifenilfosfat
79. Anhidriti maleik
80. Merkuri dhe komponimet e tij
81. Metilmerkaptene
82. Metoksietanol
83. Metil Amina
84. Metil bromuri
85. Metil kloruri
86. Metil hidrazina
87. Jodur i metilit
88. Metil izobutil karbinol
89. Metil izocionat

90. Metil merkaptene
91. Metilen difenil izocionat (M.D.I)
92. Acidi nitrik
93. p-nitroanilina
94. Nitrobenzeni
95. p-nitroklotbenzen
96. 4-nitrodifenili
97. Nitrotoluen
98. Nitroklormetan
99. Oktoklornaftalen
100. Acidi oksalik
101. Pentaboran
102. Pentaklornaftalen
103. Pentaklorfenol
104. Perklormetil merkapten
105. Fenol
106. Fluorur perkloruri
107. p-fenilen diamina
108. Eter fenil
109. Eteri fenil glicidik
110. Fenil hidrazina
111. 0-Toulidina
112. Acidi fosforik
113. Pentaklorur i fosforit
114. Pentasulfur i fosforit
115. Triklorur i fosforit
116. Ahidriti ftalik
117. Acidi pikrik
118. Propilen imin
119. Piridine
120. Kinone
121. Argjendi dhe komponimet e tij
122. Fluoroacetati i natriumit
123. Hidrooksidi i natriumit
124. Komponimet e kallait
125. Oksidi i zinkut
126. Monokloruri i squfurit
127. Pentafloruri i squfurit
128. Vinil kloruri
129. Vinil cianuri
130. Tetrakloretan
131. Tetraklormetan
132. Tetraklor naftalen
133. Tetraetil i plumbit
134. Tetrametil i squfurit
135. Tetranitrometani
136. Tetril (2,4,6-trinitrofenilmetilnitramina)
137. Toluen-2,4-diizocional (T.D.I)
138. Arseniku dhe komponimet e tij
139. Anhidriti sulfuror
